



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI QARKUT DIBËR

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**
(Drejt看 në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Këshillin e Qarkut
Dibër)

Në zbatim të nenit 26, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Dibër shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë në shërbimin civil për pozicionin:

**Drejt看 në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Këshillin e Qarkut
Dibër: Klasa III B (Bazuar në V.K. M Nr. 187, datë 08.03.2017, lidhja Nr.1)**

**Lloji i diplomës: Agronom, Gjeodet , Gjeograf, Ekonomist.
Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”.**

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë .

Për të dy procedurat lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	18 Prill 2022
Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË:	25 Prill 2022

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- a) Përfaqëson Drejtorinë në të gjitha marrëdhëniet e saj me Drejtoritë në Këshillin e Qarkut Dibër, institucionet e ndryshme si dhe me të gjitha organet shtetërore, vendore për problemet që ka kjo drejtori në kompetencë.
- b) Drejtori i DAMT-së përgjigjet para Këshillit të Qarkut dhe strukturave përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- c) DAMT përgjigjet për zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin e tokës bujqësore, si dhe të kategorive të tjera të resurseve të përcaktuara në Ligjin Nr.8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore për administrimin e tokës.
- d) Ndan funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të DAMT-së.
- e) Drejtori i DAMT-së organizon punën dhe përgjigjet për kualifikimin tekniko-profesional të punonjësve të DAMT-së, nëpërmjet trajnimeve periodike të tyre dhe informimeve për standardet bashkëkohore në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës.
- f) Drejtori i DAMT-së, për realizimin e funksionit të saj si kadastër e shumëqëllimshme, mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues që disponohet pranë saj, pavarësisht nga koha e krijimit të tij.
- g) DAMT-ja bashkërendon veprimtaritë me Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) në Njësi Administrative dhe/ose bashki, organizon punën për krijimin e dokumentacionit të ri kadastral për tokën bujqësore dhe kategoritë e resurseve të tjera, të përcaktuara me ligj.
- h) DAMT-ja bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për këmbimin e informacioneve, të treguesve dhe të të dhënave, që krijohen nga zbatimi i programeve dhe projekteve me objekt tokën bujqësore dhe disa kategori të resurseve të tjera.
- i) Bazuar në dokumentacionin, aktet, treguesit dhe informacionet e marra nga institucionet kompetente, si dhe sipas informacioneve dhe të dhënave plotësuese, që disponohen dhe krijohen nga veprimtaria e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, në Fushë-Krujë, e institucioneve të tjera shtetërore, organizon punën për krijimin e Sistemit të Informacionit për Tokën dhe integrimin gradual të tij në GIS, për të gjitha resurset që ka në administrim, brenda territorit të qarkut.
- j) Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ligji.

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III B (Bazuar në V.K. M

Nr.187, datë 08.03.2017, lidhja Nr.1);

b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

a – Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor" në shkencat Agronom, Gjeograf, Ekonomist, Gjeodet. Diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

b - Të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion, nga të cilat 1 (një) vit në nivel të mesëm drejtues.

c-Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës e noterizuar (përfshirë edhe diplomën Bachelor). *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

c - Fotokopje të librezës së punës e noterizuar (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 18.04.2022, në adresë: Këshilli Qarkut Dibër, Zyra e Burimeve Njerëzore, Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20.04.2022, Këshilli i Qarkut Dibër do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Dibër, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Dibër, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.
- Ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 8053, date 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”
- Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- Ligjin Nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Ligjin Nr. 172/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- VKM Nr. 45/2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.....”
- VKM Nr. 410, datë 02.07.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”.
- VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”.
- VKM Nr. 337, datë 22.04.2015 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Vendim Nr. 222, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ishndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Vendim Nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish - kooperativave bujqësore” i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- ☐ Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- ☐ Eksperiencën e tyre të mëparshme;

- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:
1. a) **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
2. b) **60 pikë** intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”
<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Dibër do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Vlorë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Dibër.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civil të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më ulët), të punësuar në të njëjtin apo në institucione të tjera të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë të cilët plotësojnë kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (nëpunësi civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, kategoria IV-A (Bazuar në V.K. M Nr.187, datë 08.03.2017, lidhja Nr.1);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkencat Agronom, Gjeograf,

ekonomist, Gjeodet. Diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

b - Të kenë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion nga të cilat 1 (një) vit në nivel të ulët drejtues.

c - Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje të diplomës e noterizuar (përfshirë edhe diplomën Bachelor). (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi)
- c - Fotokopje të librezës së punës e noterizuar (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 25.04.2022, në adresë: Këshilli Qarkut Dibër, Zyra e Burimeve Njerëzore, Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 05.05.2022, Njësi e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Dibër do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli Qarkut Dibër, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike".

Adresa : Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al

- Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.
- Ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 8053, date 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”
- Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- Ligjin Nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Ligjin Nr. 172/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- VKM Nr. 45/2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.....”
- VKM Nr. 410, datë 02.07.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”.
- VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “ Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”.
- VKM Nr. 337, datë 22.04.2015 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Vendim Nr. 222, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ishndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Vendim Nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish - kooperativave bujqësore” i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- deri në 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b- deri në 40 pikë për vlerësimin me shkrim;
- c- deri në 40 pikë për Intervistën e strukturuar me gojë;

Me shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”
<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli Qarkut Dibër do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Qarkut Dibër për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Qarkut Dibër duke filluar nga data **05.05.2022**

KRYETAR

Valentina Haliti

